ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Këshilli Gjyqësor i Kosovës**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **328-26-4135-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Shërbimi për mirëmbajtje dhe përmirësime në Sistemit Qendror të Evidencës Penale të Kosovës (SQEPK).**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**Tretek SH.P.K.**
NUI	**810853821**
Adresa	**Rr.Astrit Rrushi Obj.Pika Mati 1**
Vendi	**Prishtinë**
Kodi postar	**10000**
Numri Telefonit	**+38349642227**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Lirim Sulejmani**
Adresa elektronike	**tretekshpk@gmail.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**18.11.2026**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Shërbimi për mirëmbajtje dhe përmirësime në Sistemit Qendror të Evidencës Penale të Kosovës (SQEPK).

- **Njoftimi për kontratë – 03.06.2026**
- **Proces verbali i hapjes se Tenderve – 29.06.2026**
- **Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues – 14.07.2026**
- **Kërkesa për rishqyrtim – 17.07.2026**
- **Vendimi i AK në Kërkesën për rishqyrtim – 26.07.2026**
- **Vendimi i OSHP 546/26 – 04.09.2026**
- **Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues – 21.09.2026**
- **Kërkesa për rishqyrtim – 22.09.2026**
- **Vendimi i AK në Kërkesën për rishqyrtim – 23.09.2026**
- **Vendimi i OSHP 2026/0731– 03.11.2026**
- **Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues – 13.11.2026**
- **Kërkesa për rishqyrtim – 16.11.2026**
- **Vendimi i AK në Kërkesën për rishqyrtim – 17.09.2026**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒ **Jo** ☐

Jemi njoftuar përmes platformës e-prokurimit rreth procesverbalit

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ ***Jo*** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga

AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Vendimi i autoritetit kontraktues ne raport me kërkesën për rishqyrtim është refuzuar.

Te bashkangjitur ne kete ankesë gjeni vendimin e ndërmarr nga Autoriteti kontraktues

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

LIGJI Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
Neni 27 - Dosja e Tenderit
Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës
Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
Neni 131 - Shkeljet e Ligjit nga Autoriteti Kontraktues

RREGULLORE Nr. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK

Neni 25 - Kriteret e përzgjedhjes
Neni 40 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 97 - Shkeljet e rënda

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar,

Bazuar në dispozitat e nenit 109(2) të LPP-së, parashtrojmë këtë **Ankesen e tretë (3)** ndaj Vendimit të AK-së i pranuar nga OE me datën 13-11-2026 **("Vendimi i Ankimuar")** përmes së cilit është Refuzuar Kërkesa me datë 17-11-2026 në kuptim të së cilës është propozuar kthimi i tenderit në ri-vlerësim ashtu siç kishte paraparë OSHP me vendimet **nr. 2026/0546** dhe **2026/0731.**

Kjo ankesë paraqitet pasi AK, gjatë procesit të rivlerësimit, **nuk i ka korrigjuar parregullsitë e konstatuara me dy vendimet e OSHP-së nr. 2026/0546 dhe nr. 2026/0731**, por ka bërë përseri për herë të dytë interpretim të ri dhe më të gjerë të kërkesës së Dosjes së Tenderit, duke arritur në përfundimin e kundërt mbi të njëjtat dokumente të cilat paraprakisht janë shqyrtuar nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së.

Në këtë kuadër, theksojmë pretendimet tona:

PRETENDIMET ANKIMORE

-

1. MOSZBATIMI I PËRSËRITUR I DY VENDIMEVE TË OSHP-së

Me Vendimin nr. **2026/0546 të datës 04.09.2026**, OSHP ka aprovuar si të bazuar ankesën e TRETEK SH.P.K., ka anuluar Njoftimin mbi Vendimin e AK-së dhe aktivitetin e ka kthyer në rivlerësim.

Në këtë procedurë, eksperti shqyrtues kishte konstatuar konkretisht se personi i propozuar nga CMD SH.P.K. për pozitën e Menaxherit të Projektit nuk e plotëson kërkesën e Dosjes së Tenderit, përkatësisht:

- diploma "Baçelor i shkencave të inxhinierisë kompjuterike" nuk është në përputhje me kërkesën e Dosjes së Tenderit për diplomë në fushën e Shkencave Kompjuterike; dhe
- dokumentet Microsoft të dorëzuara nuk përbëjnë certifikime profesionale përfundimtare

në zhvillimin e softuerit dhe administrimin e bazave të të dhënave.

Paneli Shqyrtues ia ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit dhe e ka aprovuar ankesën tonë si të bazuar.

Megjithatë, AK pas këtij vendimi përsëri e ka rekomanduar CMD SH.P.K. për kontratë duke bërë një interpretim tjetër të të njëjtit kriter. Për këtë arsye TRETEK SH.P.K. ka qenë e detyruar të parashtrojë ankesën e dytë pranë OSHP-së.

Me Vendimin e dytë, **OSHP nr. 2026/0731 të datës 03.11.2026**, ankesa e TRETEK SH.P.K. është aprovuar përsëri si e bazuar dhe Njoftimi mbi Vendimin e AK-së është anuluar.

Në këtë vendim, OSHP ka konstatuar në mënyrë të qartë se:

"Vendimet e OSHP-së janë të detyrueshme për autoritetet kontraktuese dhe të gjitha palët në procedurë."

OSHP më tej ka konstatuar se AK nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Edhe më rëndë, Paneli Shqyrtues ka konstatuar shprehimisht se:

"AK në këtë rast qëllimshëm është duke bërë prolongimin e aktivitetit të prokurimit dhe duke bërë shkelje të dispozitave ligjore për prokurim publik."

Paneli ka konstatuar gjithashtu se **Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit dhe Komisioni i Vlerësimit janë duke vepruar në kundërshtim me nenet 59 dhe 60 të LPP-së dhe në kundërshtim me vendimet e OSHP-së.**

Pavarësisht këtyre konstatimeve të drejtpërdrejta, ju AK përsëri ka nxjerrë një vendim me të cilin nuk është zbatuar në mënyrë materiale rezultati dhe konstatimet e dy vendimeve të OSHP-së. Kjo nuk mund të konsiderohet më gabim i zakonshëm gjatë rivlerësimit. Mirë është **moszbatim i përsëritur i vendimeve të një organi kompetent shqyrtues.**

. ÇËSHTJA E MENAXHERIT TË PROJEKTIT ËSHTË SHQYRTUAR DHE VENDOSUR DY HERË

Nuk ekziston më hapësirë që AK të krijojë një interpretim të tretë për të njëjtën çështje.

Sepse kemi:

- të njëjtin aktivitet të prokurimit;
- të njëjtin OE të rekomanduar;
- të njëjtin Menaxher të Projektit;
- të njëjtën diplomë;
- të njëjtat dokumente Microsoft;
- të njëjtin kriter të Dosjes së Tenderit;
- dhe të njëjtën çështje materiale mbi përmbushjen ose jo të këtij kriteri.

Në procedurën e dytë ankimore, edhe ekspertja shqyrtuese ka konstatuar se palët dhe pretendimi janë të njëjta dhe ka rekomanduar që çështja të trajtohet si **çështje e gjykuar - "res judicata"**, sipas vendimit paraprak nr. **2026/0546.**

Pra, Autoriteti Kontraktues nuk ka të drejtë që pas çdo anulimi të vendimit të vet të nxjerrë një vendim të ri dhe përmes një arsyetimi të ri të tentojë të arrijë përsëri në të njëjtin rezultat.

Nëse AK nuk pajtohet me Vendimin e OSHP-së, rruga juridike ishte ajo e përcaktuar në këshillën juridike të vendimit , kundërshtimi pranë gjykatës kompetente.

3. SHKELJA E NENEVE 59 DHE 60 TË LPP-së DHE E KRITEREVE TË DOSJES SË TENDERIT

Vetë OSHP në Vendimin nr. 2026/0731 ka konstatuar se ZPP dhe Komisioni i Vlerësimit janë duke vepruar në kundërshtim me **nenet 59 dhe 60 të LPP-së**.

Neni 59 paragrafi 4 i LPP-së përcakton se tenderi konsiderohet i përgjegjshëm vetëm nëse është në përputhje me të gjitha kërkesat e Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes së Tenderit.

Kërkesa e Dosjes së Tenderit për Menaxherin e Projektit ka qenë:

"Diplomë universitare në fushën e shkencave kompjuterike ose certifikime profesionale nga platforma Microsoft në zhvillimin e softuerit dhe administrimin e bazave të dhënave."

Në procedurën e parë pranë OSHP-së është konstatuar se CMD SH.P.K. nuk e ka përmbushur as alternativën e diplomës dhe as alternativën e certifikimeve profesionale Microsoft.

Po ashtu, **neni 40.2 i Rregullores për Prokurimin Publik** specifikon qartë *"Tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga tenderuesit do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit dhe kontrata do t'i jepet tenderuesit që ka renditjen më të lartë.* ***Kështu, autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kritere ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve"***

Ndërsa **neni 40.2.1** përcakton se kur një aktivitet kthehet në rivlerësim me vendim të OSHP-së, rivlerësimi bëhet ...**për të korigjur parregullsitë e mundshme ligjore sipas vendimit të OSHP-së.**

4. MOSRESPEKTIMI I VENDIMEVE TË OSHP-së ËSHTË KUALIFIKUAR SI SHKELJE E RËNDË

Kjo çështje është tashmë trajtuar shprehimisht edhe nga Paneli Shqyrtues në Vendimin nr. 2026/0731.

Paneli ka theksuar se, sipas **nenit 97 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, pika h), mosrespektimi i vendimeve të OSHP-së konsiderohet shkelje e rëndë në prokurimin publik.**

Për më tepër, **neni 131 i LPP-së** përcakton se OSHP vendos gjobë prej jo më pak se 5,000 euro ndaj Autoritetit Kontraktues që nuk zbaton apo nuk respekton një urdhër të OSHP-së.

Prandaj, nxjerrja përsëri e një vendimi që ruan të njëjtin rezultat, pa korrigjuar shkeljen e konstatuar në dy vendime të OSHP-së, e ekspozon AK-në ndaj pasojave të drejtpërdrejta të përcaktuara me LPP dhe Rregulloren për Prokurimin Publik.

Në këtë fazë, AK ka në dispozicion jo një, por **dy vendime të OSHP-së**, të dyja të nxjerra në favor të TRETEK SH.P.K. dhe mbi të njëjtën çështje.

Vendimi i dytë madje përmban konstatimin eksplicit se AK po e prolongon qëllimshëm aktivitetin dhe po shkel dispozitat e prokurimit publik.

Vazhdimi i së njëjtës mënyrë të veprimit pas një konstatimi të tillë nuk mund të arsyetohet si interpretim profesional i ndryshëm.

5. DËMET E SHKAKTUARA

Veprimet e përsëritura të AK-së janë duke i shkaktuar TRETEK SH.P.K. dëme të vazhdueshme financiare.

Për shkak të përsëritjes së procedurës dhe moszbatimit të vendimeve të OSHP-së, TRETEK SH.P.K. është detyruar të përballojë në mënyrë të përsëritur:

- shpenzimet për mbështetje profesionale dhe juridike;
- shpenzimet për sigurimin dhe vazhdimin e sigurimit të tenderit, i cili është dashur të sigurohet/vazhdohet më shumë se një herë për shkak të zgjatjes së procedurës;

Këto shpenzime janë duke u rritur pikërisht për shkak të përsëritjes së vendimeve të AK-së mbi një çështje e cila është shqyrtuar dhe vendosur tashmë dy herë nga OSHP.

ANDAJ,

Duke u bazuar në faktet, provat dhe dispozitat e paraqitura më sipër, kërkojmë nga Organi

Shqyrtues i Prokurimit që:

- ta aprovojë **si të bazuar** ankesën e TRETEK SH.P.K. dhe ta anulojë Njoftimin mbi Vendimin e AK-së të datës 13.11.2026;
- të urdhërojë AK-në që ta zbatojë plotësisht Vendimin nr. 2026/0546 dhe nr. 2026/0731, ta trajtojë çështjen si të gjykuar **"res judicata"**.
- t'i shqiptojë AK-së gjobë në shumën prej 5,000.00 euro, për shkak të moszbatimit të përsëritur të vendimeve të OSHP-së;

ta detyrojë AK-në t'ia kompensojë TRETEK SH.P.K. dëmin financiar të shkaktuar nga zgjatja e procedurës dhe moszbatimi i vendimeve të OSHP-së, përkatësisht shpenzimet e dokumentuara për sigurimin dhe vazhdimin e sigurimit të tenderit.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Përveç shkeljeve të konstatuara më parë, ne gjithashtu jemi të dëmtuar nga shpenzimet e bëra me rastin e përgatitjes dhe dorëzimit të ofertës si dhe përgatitjen e kërkesës për rishqyrtim.

Këto shpenzime përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- **Shpenzimet për përgatitjen e ofertës: Këto përfshijnë kostot për hartimin e dokumenteve, analiza të nevojshme për përgatitjen e ofertës, konsulta ligjore dhe shpenzimet administrative që kanë ndodhur gjatë periudhës përgatitore.**
- **Shpenzimet për përgatitjen e Kërkesës për Rishqyrtim dhe Ankesës: Këto përfshijnë kostot për hartimin e kërkesës dhe ankesës, mbështetjen ligjore dhe administratën e nevojshme për paraqitjen e kërkesës, si dhe përgatitjen e dokumentacionit dhe provave përkatëse.**
- **Shpenzimet për sigurimin e tenderit: për shkak të zgjatjes dhe përsëritjes së procedurës, TRETEK SH.P.K. është detyruar të sigurojë/vazhdojë sigurimin e tenderit tri herë, duke bartur kosto shtesë financiare dhe bankare që nuk do të ishin shkaktuar nëse procedura do të ishte zhvilluar dhe përfunduar në përputhje me dispozitat ligjore.**

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*